



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, 20 janar 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Qamile Morina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Gjylnaze Syla.

Munguan: Sllobodan Petroviq, Nurishahe Hulaj dhe Teuta Hadri.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Përgatitje për organizimin e dëgjimit publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Përgatitje për organizimin e dëgjimit publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi

Sadik Idriz – Tha se Komisioni në kuadër të monitorimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi ka vendosur ta organizojë një dëgjim publik për të mbledhur informata për zbatueshmërinë dhe për pengesat në zbatimin e këtij ligji. Propozoi që dëgjimi publik të mbahet më 4 shkurt. E hapi diskutimin për shqyrtimin e listës së të ftuarve në dëgjim publik.

Mimoza Ahemtaj – Tha se në listën e të ftuarve të mundshëm për dëgjim publik është paraparë të ftohet edhe Sindikata për Punë Ndërkombëtare e Kosovës. Në radhë të parë ne nuk kemi njohuri se kush është kjo sindikatë dhe nuk ka nevojë të ftohet në dëgjim publik, meqenëse është paraparë të ftohet Federata Sindikale e Shëndetësisë e Kosovës.

Në listën e të ftuarve të mundshëm janë paraparë: shoqata e anesteziologëve edhe asociacioni i anesteziologëve- propozoi të fshihet njëra.

Propozoi që në dëgjim publik, të ftohet një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Bujar Bukoshi – Propozoi të ftohen së bashku degët operative: Shoqata e Ortopedëve dhe Traumatologëve e Kosovës, Shoqata e Kirurgëve e Kosovës, Shoqata e Kirurgëve Pediatrikë e Kosovës dhe Shoqata e ORL-së.

Rita Hajzeraj - Tha se përderisa secili sektor ka një shoqatë të veten, është mirë që këto shoqata të ftohen ndaras në dëgjim publik. Po të ishin të bashkuara të gjitha këto shoqata në një, atëherë do të ishte vetëm një shoqatë.

Flora Brovina – Propozoi që në dëgjim publik të ftohet edhe Asociacioni për Mbrojtjen e Pacientëve. Tha se ne nuk e kemi fondin e sigurimeve shëndetësore, por shumë organizata të sigurimeve kanë filluar të bëjnë kontrata për sigurime shëndetësore. Është mirë të ftohet njëra nga kompanitë e sigurimeve për të marrë informata për relacionin ndërmjet këtyre sigurimeve shëndetësore dhe institucioneve private shëndetësore.

Sadik Idriz – Tha se kjo është një temë për të cilën do të diskutohet kur të organizohet dëgjimi publik për Ligjin për sigurime shëndetësore, posa ky ligj të procedohet në Kuvend.

Gjylnaze Syla – Tha se në listën e të ftuarve për dëgjim publik duhet të hyjnë edhe institucionet që kanë aplikuar për licencim dhe që nuk janë licencuar, në mënyrë që të marrim informata se ku qëndron problemi i moslicencimit të tyre. Po ashtu propozoi të ftohen edhe përfaqësues të institucioneve private laboratorike.

Armend Zemaj – Tha se të gjitha institucioneve, që i ka vizituar grupi i punës, u ka dhënë mundësi që vërejtjet konkrete për zbatimin e Ligjit t'i dërgojnë me shkrim. Klinika Gjermane e Syrit është e vetme që ka bërë komente sa i përket Ligjit, andaj propozoj të ftohet në dëgjim publik.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Dëgjimi publik lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi do të mbahet më 4 shkurt 2009, në orën 11:00, në sallën C-301.

Të ftuar në dëgjim publik do të jenë përfaqësues nga: Ministria e Shëndetësisë - përfaqësues nga Zyra Ligjore, Inspektorati i Shëndetësisë, Bordi për Licencim të Institucioneve Private Shëndetësore, të komunave: Prishtina, Peja, Prizreni, Gjilani dhe Mitrovica dhe Asociacioni i Mjekëve dhe i Stomatologëve Privatë e Kosovës.

Nga degët operative të ngjashme të ftohen: Shoqata e Kirurgëve e Kosovës, Shoqata e Ortopedëve dhe e Traumatologëve e Kosovës, Shoqata e Kirurgëve Pediatrikë e Kosovës, Shoqata e ORL-së dhe Shoqata e Urologëve e Kosovës, Federata Sindikale e Shëndetësisë e Kosovës, Shoqata e Internistëve e Kosovës, Shoqata e Kardiologëve e Kosovës, Shoqata e Infektologëve e Kosovës, Asociacioni i Anesteziologëve, Shoqata e Obstetërve dhe e Gjinekologëve e Kosovës, përfaqësues të institucioneve private laboratorike, Klinika Gjermane e Syrit.

Plotësimin eventual të kësaj liste të të ftuarve për dëgjim publik do ta bëjnë deputetët: Sadik Idriz, Qamile Morina dhe Rita Hajzeraj.

4. Të ndryshme

a) Ligji për sigurime shëndetësore

Flora Brovina – Tha se Shqipëria ka filluar me sistemin e sigurimeve shëndetësore dhe ndoshta është mirë që Komisioni ta ftojë drejtoreshën e sigurimeve shëndetësore në takim.

Qamile Morina – Tha se ne jemi të interesuar ta kemi Ligjin për sigurime shëndetësore në pajtim me financat dhe me ligjet e BE-së. Unë e kam bërë një kërkesë në ICO, që ta mbështes një grup të Komisionit për Shëndetësi, për ta vizituar Slloveninë pikërisht për Ligjin e punës dhe për Ligjin për sigurime shëndetësore. Edhe Shqipëria ka probleme me sigurime shëndetësore dhe profesor Tritan Shehu ka propozuar të organizohet një konferencë e përbashkët pikërisht për sigurime shëndetësore.

b) Shqyrtimi i ankesës së pronarit të fabrikës për prodhimin e produkteve farmaceutike “New-Co Farmakos”- Prizren

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit për ankesën e prof. dr. Azem Lajçi - pronar i “New-Co Farmakosit” të Prizrenit, kundër vendimit me të cilin refuzohet rilicencimi i kësaj fabrike për prodhimin e produkteve farmaceutike. Hapi diskutimin lidhur me këtë.

Qamile Morina – Tha se nga arsyetimi i ankesës del se mosrilicencimi i kësaj fabrike është pasojë e mungesës së PMP-së (karakteristika të barit). Ajo ka kërkuar qasje në dokumentet e AKPM-së dhe ka marrë përgjigje negative. AKPM-ja është shumë e mbyllur dhe ka bërë shumë shkelje. Udhëzimi administrativ nr. 2008/04, i nxjerrë nga AKPM-ja, është në kundërshtim të plotë me Ligjin. Sipas Ligjit produktet farmaceutike të prodhuara edhe në vend duhet ta kenë GNP-në (cilësinë e produktit), ndërsa sipas Udhëzimit nr. 2008/04 produktet farmaceutike nuk duhet ta kenë GNP-në.

Rita Hajzeraj – Tha se kjo fabrikë ka qenë e licencuar. Ligji që po zbatohet tash ishte në fuqi edhe në kohën kur është licencuar kjo fabrikë. Ne duhet të shohim se kur është shkelur Ligji, në kohën kur kjo fabrikë ka qenë e licencuar apo tani kur i është refuzuar kërkesa për rilicencim.

Mimoza Ahmetaj – Propozoi që shkresa për të cilën Komisioni është duke diskutuar të lihet për diskutim në mbledhjen e radhës, sepse kjo shkresë është dërguar me vonesë.

Flora Brovina – Propozoi që në njërin nga mbledhjet e Komisionit të ftohen për t'u dëgjuar përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe pronari i fabrikës për prodhimin e produkteve medicinale, në mënyrë që Komisioni të marrë informata për pengesat e rilicencimit të kësaj fabrike.

Gjynaze Syla – Tha se duhet të dëgjohen edhe përfaqësuesit e inspektoratit për produkte të pajisjeve. Ajo tha se duhet të dëgjohen të gjitha palët, në mënyrë që Komisioni të mund ta japë një sugjerim.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në një nga mbledhjet e radhës Komisioni do të ftojë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuesin e fabrikës "New-Co Farmakos", përfaqësues nga inspektorati për produkte të pajisjeve dhe përfaqësues nga AKPM-ja.

c) Ndryshimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Armend Zemaj – Tha se Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, sipas planit të punës, rregullisht ka mbajtur mbledhje të martën, në orën 11:00. Edhe Komisioni për Legjislacion mban mbledhje të rregullta të martave - në këtë komision ky është anëtar. Me qëllim që të ketë mundësi të marrë pjesë në mbledhjet e të dy komisioneve, propozoi që mbledhja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të mbahet ditën e martë, në orën 12:00.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e përkrahu propozimin e deputetit Armend Zemaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz